



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

## **Projekt-V E N D I M**

### **Neni 1**

Me këtë vendim firmës **N.P.T “ARTA TEX”**, me seli në Rr. “Faik Konica” nr.17 Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson **Agim Mustafa nga Peja**, adresa Rr. “Faik Konica” nr.17; **Ijepen** në shfrytëzim afatgjatë deri **35, (tridhjetë e pesë)** vite, **Parcela P-72116029-00333-2**, me sipërfaqe prej: **21194m<sup>2</sup>** dhe Objekti (shtëpia-ndërtesa) me sipërfaqe **3609 m<sup>2</sup>** së bashku me mjetet themelore të cilat gjinden në objekt, në vendin e quajtur **“Nerezine”** zona kadastrale Mushtisht, sipas certifikatës së pronës Nr. 2096-2022 të datës 10.06.2022, në emër të Komunës së Suharekës, për ushtrimin e veprimtarisë **“Prodhimin e tekstilit-qepja e të gjitha llojeve të uniformave”**, sipas rekomandimit 01-Nr-052-64839 të datës 06.10.2022, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

### **Neni 2**

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **00.10.2022** dhe përfundon afati më datën, **00.10.2121**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

### **Neni 3**

**3.1 Obligohet;** Kryetari i Komunës që me **personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të Komunës**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

**3.2. Obligohen;** përfituesi i pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personi fizikë dhe juridikë të cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancionin bankar ose sigurimin nga kompanitë e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

**3.3** Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

#### **Neni 4**

**4.1** **Obligohen** shfrytëzuesit e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtij vendim, ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

**4.2** Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

#### **Neni 5**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

### **K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
**Mr. ec Bexhet KUÇI**